

ATRC organizon trajnime për "Buxhetimin me pjesëmarrje" në 10 Komuna të Kosovës

ATRC gjatë muajve prill-qershor 2011 ka mbajtur 10 trajnime me temë "Buxheti me pjesëmarrje". Pjesëmarrës në këto trajnime ishin anëtarët e Kuvendit Komunal, zyrtarët komunal dhe përfaqësuesit e Shoqërisë Civile të 10 Komunave të Kosovës: Pejë, Gjakovë, Prizren, Klinë, Suharekë, Istog, Malishevë, Deçan, Rahovec dhe Dragash.



Trajnimet u fokusuan në nevojën e përfshirjes së qytetarëve në procesin e buxhetimit me pjesëmarrje, si një mekanizëm që u mundëson qytetarëve që të përfshihen në procesin e vendimmarrjes që nga faza e planifikimit të buxhetit komunal deri në implementimin e tij. Këto aktivitete janë vazhdimësi e projektit "Zgjidhja e Konfliktit Social" të financuar nga Qendra Ndërkombëtare

Trajnim i përkrahur nga Intercooperation

ATRC ka organizuar trajnim tre ditor me temë "Dizajnimi i projekt propozimit", për zyrtarët për barazi gjinore dhe zyrtarët tjerë komunal si dhe për përfaqësuesit e shoqërisë civile të 9 komunave të Kosovës: Kamenicë, Novo Bërdë, Kllokot, Hani i Elezit, Kaçanik, Ranillugë, Viti, Partesh dhe Shtërpce.

Trajnimi është fokusuar në shpjegimin e përgjithshëm të të gjitha elementeve të një projekt propozimi. Metodologjia e trajnimit është bazuar në qasjen logjike, e cila ju ka mundësuar pjesëmarrësve zhvillimin e projekteve nga idetë fillestare në përcaktimin e objektivave, planin e zbatimit të projektit dhe buxhetin. Gjatë trajnimit pjesëmarrësit kanë zhvilluar nga dy draft projekte në fushën e barazisë gjinore dhe të infrastrukturës.

Trajnim i përkrahur nga Care International Kosova

ATRC me përkrahje nga Care International Kosova gjatë muajit qershor ka mbajtur trajnimin dy ditor me temë "Lidershipi dhe Qeverisja". Pjesëmarrës në këto trajnime ishin përfaqësues të Organizatave joqeveritare rinore, përfitues të Care International Kosova.

Qëllimi i organizimit të këtij trajnimi ishte ngritja e kapaciteteve të pjesëmarrësve për udhëheqje efektive të OJQ-ve dhe sektorit jofitimprurës. Trajnimi ka trajtuar kuptimin e Lidershipit dhe qeverisjes, konceptet, strukturat dhe parimet e udhëheqjes së OJQ-ve, rolin e bordit, funksionet dhe përgjegjësitë, llogaridhënien e OJQ-ve, procesin e vendimmarrjes dhe ndjekjen dhe mbështetjen e performancës.

ATRC - CSSProject for Intergative Mediation trajnojnë dhe certifikojnë 15 Ndërmjetësues

Duke filluar nga 25 qershori deri më 8 korrik 2011, ATRC në partneritet me Organizatën: CSSProject for Intergative Mediation si dhe Ministrinë e Drejtësisë, përkatësisht Komisionin për Ndërmjetësim, organizuan trajnimin intensiv dyjavor për 15 ndërmjetësuesit e regjionit të Prishtinës, të cilët në fund u certifikuan nga ATRC dhe CSSP.



Trajnimi ishte ndarë në dy faza: në trajnimin bazik dhe atë të avancuar, duke synuar që brenda dy jave, pjesëmarrësit të pajiseshin me aftësitë e nevojshme si dhe shkathhtësitë e një ndërmjetësuesi, në mënyrë që angazhimi i tyre si ndërmjetësues në praktikë të jetë sa më i lehtë dhe njëkohësisht sa më i suksesshëm.

Sipas Ligjit për Ndërmjetësim, të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës në 2008, ndërmjetësuesit do të licencohen nga Ministria e Drejtësisë dhe më pas do të angazhohen drejtpërdrejtë në procesin e ndërmjetësimit në rastet të cilat referohen nga gjykatat ose edhe drejtpërdrejtë, si një nga mënyrat më të shpejta në zvogëlimin e lëndëve të grumbulluara në gjykata.

ATRC asiston Komunitetet e reja në hartimin dhe modifikimin e rregulloreve për transparencë

ATRC edhe gjatë këtij tremujori ka vazhduar të punojë në ngritjen e kapaciteteve të tri komunave të reja: Gracanice, Klokot dhe Ranillugë. Gjatë kësaj periudhe u organizuan nga tri punëtori në secilën komunë, qëllimi i së cilave ishte facilitimi i procesit të hartimit të rregulloreve komunale. Në të tri këto komuna u formuan grupe punuese, të përbëra nga anëtarët e Kuvendit Komunal dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, të cilët u angazhuan në hartimin dhe modifikimin e rregulloreve për transparencë. Si rezultat i këtyre punësive Komuna e Gracanices hartoi draft rregulloren për transparencë, kurse komuna e Klokotit dhe e Ranillugut modifikuan rregulloren ekzistuese në harmoni me ligjet në fuqi. Rregulloret për transparencë në këto komuna u hartuan/modifikuan në përputhje me Ligjin për qasje në dokumentet publike si dhe me Rregulloren për shërbimin e komunikimit qeveritar me publikun.

Këto aktivitete janë pjesë e projektit "Praktika të suksesshme-Komuna funksionale" të financuar nga fondet e USAID.

Letër nga Ambasadorët e Vegjël të Mjedisit

"Ambasadorët e vegjël të mjedisit", i kanë drejtuar një letër përfaqësuesve të institucioneve të Kosovës, në të cilën kanë shprehur shqetësimin e tyre për gjendjen e mjedisit. Në letrën e tyre ndër të tjera ata shkruajnë: "E duam të kaltër dhe të kthjellët qiellin tonë. I duam të pastër lumenjtë dhe burimet tona. E duam pjellore dhe të shëndetshme tokën e bukës sonë. I duam të gjelbra dhe plot gjallesa pyjet tona. I duam pa mbeturina dhe pa zhurmë qytetet tona. Duam më shumë hapësira për lojë dhe argëtim. Mos na shkatërroni ardhmërinë tonë. E duam Kosovën të pastër".

Projekti Ambasadorët e vegjël të mjedisit implementohet nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim-ATRC, mbështetur nga Ambasada Amerikane në Prishtinë, projekt i cili ka për qëllim të rris nivelin e edukimit dhe ndërgjegjësimit të fëmijëve të shkollave fillore për mbrojtjen e mjedisit.



ATRC dhe PILPG organizojnë konferencën "Drejtësia dhe Njerëzit"

Më 30 Qershor, 2011, në kampusin e Universitetit Amerikan në Kosovë, u mbajt konferenca e parë në kuadër të kampanjës të përbashkët nga ATRC dhe PILPG të quajtur "Drejtësia dhe Njerëzit: Përforcimi i sundimit të ligjit në Kosovë" dhe kishte për qëllim të sjellë së bashku OJQ-të, grupet e shoqërisë civile dhe udhëheqësit 'grassroot' të interesuar për akses më të madh në drejtësi dhe aspekte të reformimit të sistemit të drejtësisë. Pjesëmarrës ishin ekspertë nga segmente të ndryshme të shoqërisë në Kosovë dhe disa nga qëllimet kryesore të diskutimit ishin: për të gjeneruar njohuri dhe rekomandime për përmirësimin e sistemit aktual ligjor, shqyrtimi i mënyrave për inkurajimin e qytetarëve të Kosovës për të marrë iniciativë në lidhje me sistemin e tyre të drejtësisë, për t'u angazhuar për reformat e nevojshme, për të analizuar perceptimet e qytetarëve për sistemin e drejtësisë, si dhe për të identifikuar mënyrat për të fuqizuar qytetarët dhe shoqërinë civile. Kontributet e ofruara nga pjesëmarrësit e tryezës së rrumbullakët dhanë një pasqyrë të rëndësishme të problemeve në fushat e drejtësisë, reformës së sistemit, qasjes në drejtësi etj. Kjo konferencë përfaqëson vetëm hapin e parë nga shumë ngjarje të ardhshme të cilat janë të dizajnuara për promovimin e kësaj kampanje.



ATRC trajnon stafin e OJQ-se: Aksioni Kundër Dhunës dhe Ndërtimi i Paqës - ANP në Gjilan

Me datë 25-26 Qershor 2011, ATRC organizoi trajnimin dy ditor për stafin e organizatës Aksioni kundër dhunës dhe ndërtimi i Paqës në Gjilan dhe partnerëve të saj, të cilët kanë qenë të angazhuar në zhvillimin e aktiviteteve, në kuadër të projektit "Let's change Something" i financuar nga USAID përmes ISC - Programit Kosovar për Forcimin e shoqërisë civile në Kosovë.

Në trajnim morën pjesë përfaqësues të organizatave rinore nga: Gjilani, Zhegra, Vitia, Lladova dhe Kamenica, si: organizata ANP, Këshilli Lokal për Veprim Rinor (Local Council for Youth Action), etj.

Qëllimi kryesor i këti trajnimi dy ditor për avokim të avancuar ishte krijimi i planit të veprimit në bazë të strategjisë së avokimit për vazhdimin e shtytjes përpara të procesit për krijimin e qendrës rinore multikulturore në Gjilan.

ATRC partner implementues për Kosovë e projektit: Synergy for Energy Awaraness in SEE

Duke filluar nga prilli i vitit 2011, ATRC në cilësinë e partnerit implementues për Kosovë, dhe gjashtë organizata të gjashtë shteteve të regjionit kanë filluar implementimin e projektit: Synergy for Energy Awaraness in SEE Region. Përmes këtij projektit, organizatat partnere synojnë të bëjnë presion tek qeveritë e vendeve respektive që të orientojnë zhvillimin energjetik në vend sipas standardeve evropiane, duke i dhënë prioritet prodhimit të energjisë alternative ose me sa më pak ndotje në mjedis.

Për këtë qëllim, janë planifikuar një numër aktivitete, fillimisht në nivele nacionale duke u bashkuar me pas në nivel regjioni.

www.advocacy-center.org

MISIONI I ATRC-së

ATRC është organizatë kosovare, jo-ftimprurëse e cila synon rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në përgjithësi dhe shoqërisë civile në veçanti në proceset vendimmarrëse përmes ofrimit të shërbimeve dhe bashkëpunimit aktiv me palët me interes në vend dhe jashtë tij si një nga kushtet themelore për një shoqëri të zhvilluar dhe demokratike.

PROGRAMET KRYESORE TË ATRC

1. Programi i ngritjes së kapaciteteve, i cili synon që përmes trajnimeve dhe ofrimit të konsulencave, të rrisë kapacitet e organizatave joqeveritare në Kosovë në fushën e zhvillimit të përgjithshëm organizativ, menaxhimit të projekteve, zhvillim të fushatave të suksesshme të avokimit etj.
2. Programi i administrimit të granteve, i cili synon të ndihmojë organizatat joqeveritare lokale përmes granteve të vogla kryesisht në fushata avokimi në nivel lokal dhe nacional.
3. Programi për Avokim, përmes projekteve të ndryshme ATRC synon të avokojë në institucione nacionale dhe lokale për probleme të ndryshme të cilat janë preokupim dhe brengë e qytetarëve në përgjithësi.
4. Informimi, përmes të cilit ATRC synon të ofrojë informacione në mënyrë elektronike në ueb faqe, në lidhje me diskutimet publike dhe tryeza të rumbullakëta, ndërtimet e koalicioneve, ndërmjetësim partneriteti dhe bashkëpunimi. ATRC, gjithashtu në kuadër të kësaj komponente ofron librari me 1756 tituj të ndryshëm, si: botime për çështjet sociale, politike dhe ekonomike që lidhen me Kosovën dhe rajonin, analiza, studime, hulumtime dhe dokumente tjera me rëndësi mbi fushëveprimtarinë e organizatave joqeveritare në përgjithësi, të krijuara nga organizata joqeveritare brenda dhe jashtë Kosovës.

ADVOCACY TRAINING & RESOURCE CENTER - ATRC

Rr. GAZMEND ZAJMI NR.20 PRISHTINË,

PHONE/FAX: +381(0)38 244810

E-MAIL: info@advocacy-center.org

web page: www.advocacy-center.org